



R A P O R T

**PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
INSPEKTORIATIN E LARTË TË DEKLARIMIT, KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Tiranë, 2013





**RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË
INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE.**

Pasqyra e Lëndës	fq. 1
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	fq. 2
1.1 Hyrje	fq. 2
1.2 Medota e auditimit	fq. 2-3
1.3 Gjetjet kyçe	fq. 4-5
1.4 Zbatimi i rekomandimeve të lëna	fq. 5
ANEKSI A – MBULIMI I AUDITIMIT	fq. 5-25
ANEKSI B – GJETJET NGA AUDITIMI	fq. 25-29
ANEKSI C – ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË	fq. 29-30



PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Hyrje.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 327/1, datë 25.03.2013, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u krye auditimi në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përfaqësuar nga znj. Zana Xhuka, me detyrë Inspektor i Përgjithshëm, për auditimin e ushtruar me objekt: "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar".

Auditimi u krye nga data 01.04.2013 deri më 10.05.2013, sipas drejtimeve të përcaktuara në këtë program auditimi, për periudhën e veprimtarisë së ushtruar nga subjekti i audituar nga data 01.10.2010 deri më datën 31.12.2012, nga grupi i auditimit i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar të KLSH-së, Aleksandër Tereziu, Ludmilla Sulaj dhe Kujtim Rama.

Auditimi u krye për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje. Përveç auditimit të dokumentacionit jemi bazuar edhe në këshillimin dhe ballafaqimet me stafin drejtues e atë administrativ të subjektit të audituar.

Në përfundim të auditimit me personat përkatës përgjegjës në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave u bënë ballafaqimet për gjetjet nga auditimi, dhe pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e këtyre punonjësve, janë marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, u përgatit dhe u paraqit Projektraporti i Auditimit me shkresën nr. 327/2, datë 30.05.2013, mbi bazën e të cilit u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Si konkluzion. *Institucioni i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave paraqet një performancë të mirë të menaxhimit të fondeve buxhetore, pasi ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit, ka administruar siç duhet vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion, bazuar në rregullat dhe standardet buxhetore.*

Raportimet financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale të institucionit dhe i kanë dhënë menaxherit të lartë të gjithë informacionin e nevojshëm për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm ka funksionuar mirë, pasi ka bërë të mundur arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë por, ka nevojë edhe për disa përmirësime të trajtuara sipas gjetjeve nga auditimi.

1.2 Metoda e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit është përdorur kryesisht metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyrë të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, për të parë nëse ekzistojnë gabime, parregullsi dhe veprime të paligjshme.

Gjatë planifikimit parashikuam që zonat me risk ndodhen tek investimet dhe tek blerjet e mallrave por, nisur nga fakti që sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon mirë dhe se, për periudhën objekt auditimi institucioni ka përdorur pak fonde e konkretisht, për vitin 2010, ka përdorur 86,414



mijë lekë, për vitin 2011, ka përdorur 88,195 mijë lekë dhe për vitin 2012, ka përdorur 71,036 mijë lekë, risku është i nivelit të ulët.

Gjithashtu, për tu siguruar që fondet buxhetore janë të plota dhe të vlefshme, si dhe për të parë nëse veprimet janë të rregullta, të plota dhe të regjistruara, u audituan zonat e llogarisë 600 "Pagat", 601 "Sigurimet shoqërore", 602 "Mallra e shërbime", 230+231 "Investime", zona e të ardhurave dhe tregues të tjerë financiar.

Institucioni nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm.

Për zbatimin e auditimit u mbështetëm në dispozitat ligjore si më poshtë:

- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Urdhri nr. 554, datë 29.12.2011 "Për miratimin e rregullores së brendshme për veprimtarinë dhe funksionimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive".
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 10035, datë 02.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj".
- Vendimin i KM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998".
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 901, datë 19.12.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve të kabineteve dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e disa institucioneve të pavarura", i ndryshuar.
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 13.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të zgjedhjeve", i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar.
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 11.08.2011, i ndryshuar.
- Akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre, etj.



1.3 Gjetjet kyçe të auditimit dhe impakti i tyre tek pasqyrat financiare.

1.3.1. Nga auditimi i listëpagesave rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, institucioni, ka respektuar numrin e punonjësve në përputhje me strukturën organike. Të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës dhe se janë respektuar nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve duke përfshirë pagën bazë mujore, shtesat mbi pagë, etj. Gjithashtu, nga auditimi me zgjedhje për pagat, sigurimet shoqërore, fondin e veçantë, tatimin mbi të ardhurat personale shpërblimet, ndihmat ekonomike, etj., rezultoi se, ato janë llogaritur në bazë të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqe 11-12 të Raportit të Auditimit.

1.3.2. Nga auditimi i gjendjes debitore dhe kreditore të llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konformë rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogarinë sintetike dhe ato analitike dhe se, nuk kishte pozicione, apo kontabilizime të parregullta, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 9-11 të Raportit të Auditimit.

1.3.3. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të arkës në lekë dhe valutë dhe ato nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimi rezultoi se, veprimet kontabël janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në ditar dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me ekstraktin e saj. Të gjithë urdhër shpenzimet janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Financave nr. 6153, datë 27.05.2009, dhe mbështeten në dokumentet ligjorë justifikues, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 12-13 të Raportit të Auditimit.

1.3.4. Nga auditimi i transaksioneve të kryera për mallra e shërbime të ndryshme për nevojat e institucionit rezultoi se, janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe udhëzimet e lëshuara nga APP-ja për këtë qëllim, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë përdorimin e fondeve buxhetore. Të gjitha urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës justifikues që argumentojnë shpenzimin e kryer, trajtuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 12-13 të Raportit të Auditimit.

1.3.5. Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja rezultoi se, janë respektuar kriteret e përcaktuara në VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar, trajtuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 12-13 të Raportit të Auditimit.

1.3.6. Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për udhëtim e dieta jashtë shtetit u konstatua se, për këto shpenzime janë zbatuar kriteret e përcaktuara në VKM nr. 304, datë 08.05.2003 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat e punonjësve të ministrive dhe të institucioneve buxhetore, kur dalin me shërbim jashtë shtetit”, i shfuqizuar me VKM nr. 870, datë 14.12.2011. Urdhër shpenzimeve dhe mandat pagesave u janë bashkëlidhur urdhër shërbimet, faturat e hoteleve, biletat e lëshuara nga agjencitë e udhëtimeve dhe dokumentacioni tjetër justifikues për shpenzimet e kryera, trajtuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 12-13 të Raportit të Auditimit.

1.3.7. Nga auditimi lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultoi se, nëpunësit e njësisë respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe se, në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues njësia ka hartuar rregulloren e brendshme dhe rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave. Në nenin 26 “Etika për punonjësit e ILDKP” të rregullores së brendshme, përcaktohet se punonjësit e institucionit respektojnë rregullat e etikës në administratën publike por, njësia nuk ka Kod Etik, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, trajtuar në Aneksin B- Gjetjet nga Auditimi, pika 1.1, faqe 25 të Raportit të Auditimit.



1.3.8. Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se, për vitin 2012, Autoriteti Kontraktor në bazë të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, pika 3, germa “b” e “dh”, ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, regjistrin e parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve publike por, nuk ka dërguar një kopje në Ministrinë e Financave, trajtuar në Aneksin B- Gjetjet nga Auditimi, pika 2.1, faqe 27 të Raportit të Auditimit.

1.3.9. Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se, argumentimi dhe përlllogaritja e fondit limit, nuk është pjesë përbërëse e administruar e dosjes së tenderit. Për këtë mangësi është lënë rekomandim dhe nga auditimi i kaluar por, nuk është zbatuar, trajtuar në Aneksin B- Gjetjet nga Auditimi, pika 3.1, faqe 27 të Raportit të Auditimit.

1.3.10. Nga auditimi rezultoi se, Njësia e Prokurimit me përfundimin e procedurave të prokurimit, nuk ka kryer inventarizimin për çdo dosje, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 15 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, trajtuar në Aneksin B- Gjetjet nga Auditimi, pika 4.1, faqe 28 të Raportit të Auditimit.

1.4 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Për përmirësimin e gjendjes, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 414/5, datë 10.02.2011 “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”, ka rekomanduar për zbatim 1 masë organizative. Për zbatimin e rekomandimit të lënë, institucioni me shkresën nr. 777/1, datë 02.03.2011, ka njoftuar KLSH-në, për masat e marra.

Nga auditimi rezultoi se, rekomandimi i lënë nuk është zbatuar, trajtuar në mënyrë të detajuar në aneksin C – Zbatimi i rekomandimeve të mëparshme, faqet 29-30 të Raportit të Auditimit.

ANEKSI A – MBULIMI I AUDITIMIT.

1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiare dhe kontrollit.

Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Në kuptimin e këtij ligji menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Nga auditimi rezultoi se:

Njësia, në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2012, dhe një kopje e ka dërguar në Ministrinë e Financës me shkresën nr. 286, datë 26.02.2013.

a. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

1. Vendosi e objektivave.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.



Për vitin 2012, punonjësit e njësisë kanë vepruar dhe kanë realizuar detyrat e tyre, bazuar në rregulloren e brendshme për veprimtarinë dhe funksionimin e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, miratuar me Urdhrin nr, 554, datë 29.12.2011 të Inspektorit të Përgjithshëm. Në rregullore janë përcaktuar objekti dhe fusha e zbatimit, dispozita të përgjithshme, struktura dhe organika, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë të veçantë. Në rregullore ka një nen mbi orarin e punës dhe qëndrimi gjatë orarit të punës dhe një nen për etikën për punonjësit e njësisë por, emërtimi i institucionit sipas rregullores nuk përputhet me emërtimin e institucionit sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012 neni 19 ku thuhet se: “Kudo në këtë ligj, emërtimi Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Për vitin 2012, njësia në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar projektbuxhetin duke marrë në konsideratë dhe risqet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave dhe e ka dërguar atë në Ministrinë e Financave me shkresat nr. 908/3, datë 28.04.2011 “Kërkesat buxhetore afatmesëm për 2012-2014 të ILDKP” dhe nr. 2855/1, datë 29.08.2011 “Kërkesat buxhetore afatmesme 2012-2014 të ILDKP”.

Njësia për realizimin e prioritetëve apo, të objektivave të saj ka hartuar rregulloren për procedurat e ruajtjes, mbrojtjes të aktiveve në ILDKP me nr. 1819 prot., datë 30.04.2012, strategjia dhe plani i veprimit antikorrupsion për ILDKP 2011-2013, rregulloren e brendshme mbi veprimtarinë e institucionit, rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave në ILDKP, etj. Gjithashtu njësia ka caktuar prioritetet afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata, si për nisma ligjore dhe për aktivitete të ndryshme zbatuese për periudhën 2012-2015.

Lidhur me përmbajtjen e projektbuxhetit dhe të objektivave, menaxherët e njësisë krahas informacioneve periodike janë të informuar në formë shkresore me anë të një materiali apo, relacioni ndërsa, nëpunësit me anë të takimeve të ndryshme. Njësia nuk ka strukturë varësie.

2. Etika personale dhe profesionale.

Nëpunësit e njësisë respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe se, në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues njësia ka hartuar rregulloren e brendshme dhe rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave. Në nenin 26 “Etika për punonjësit e ILDKP” të rregullores së brendshme, përcaktohet se punonjësit e institucionit respektojnë rregullat e etikës në administratën publike por, njësia nuk ka Kod Etik, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, trajtuar në Aneksin B- Gjetjet nga Auditimi, pika I.1, faqe 25 të Raportit të Auditimit.

3. Struktura organizative.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2012, ka funksionuar dhe është i organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 228, datë 29.01.2009 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”, i ndryshuar me Vendimin nr. 93, datë 07.04.2011. Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar emërtimin e pozicioneve të punës, kategorinë dhe numrin e punonjësve gjithsej, që sipas organikës është 44.

Struktura ofron vija të qarta të përgjegjësi dhe të kalimit të informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga drejtuesi apo, menaxherët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. Drejtoritë dhe sektorët i kanë të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, numri gjithsej i punonjësve sipas organikës krahasuar me faktin, paraqitet si më poshtë:



Emërtimi	Viti 2010			Viti 2011			Viti 2012		
	Plan	Fakt	Ndr.	Plan	Fakt	Nd.	Plan	Fakt	Ndr.
I. Punonjës gjithsej	44	44	-	44	44	-	44	44	-
- Drejtues	1	1	-	1	1	-	1	1	-
- Specialistë	38	38	-	38	38	-	38	38	-
- Teknikë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
- Nëpunës të thjeshtë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
- Punëtorë	5	5	-	5	5	-	5	5	-
<i>II. Punonjës të përkohëshëm</i>	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Nga sa më lart, njësia për vitin 2012, ka punuar me 44 punonjës, duke respektuar numrin e punonjësve në organikë.

Bazuar në ligjin nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, njësia për vitin 2012, me Urdhrin e Titullarit nr. 62, datë 05.04.2012, nr. 1480, prot., datë 05.04.2012, ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) ndërsa, me Urdhrin nr. 63, datë 05.04.2012, nr. 1481 prot., datë 05.04.2012, ka krijuar Ekipin e Menaxhimit të Programit për programim buxhetor “Planifikim-Menaxhim-Administrim”. Në bazë të ligjit për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, z. Gëzim Çopa me detyrë Sekretar i Përgjithshëm me shkresën e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 2013, datë 29.07.2009, është caktuar nëpunësi autorizues ndërsa, zj. Kozeta Ndoi me detyrë Drejtore Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse është caktuar nëpunësi zbatues dhe me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17/48, datë 17.01.2013, është bërë rikonfirmimi i nëpunësit zbatues.

4. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me punëdhënësin në bazë të ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe kodit të punës. Në bazë të këtyre dispozitave ligjore, si dhe ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për prokurimin publik, për kontabilitetin, etj., lejon menaxherin e institucionit që, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura. Njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tij dhe në praktikë delegimi i detyrave nuk funksionon.

Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se, punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga drejtuesit dhe ajo është e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

Për vitin 2012, Grupi i Menaxhimit Strategjik, ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje dhe ka diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

5. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, njësia ka miratuar përshkrimin e punës për çdo pozicion pune në institucion ku përfshihen detyrat individuale që duhen kryer dhe ka bërë vlerësimin vjetor të punës së tyre. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2012, janë trajnuar 36 punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Trajnimet janë kryer në bashkëpunim me Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike dhe me Shkollën e Magjistraturës.

b. Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore institucionit analizon dhe bën kontrollin e risqeve hap pas hapi të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Gjatë vitit 2012, Ministria e Financave dhe Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike ka organizuar trajnime me punonjësit



e institucionit lidhur me menaxhimin e riskut dhe për këtë vit, njësia ka hartuar regjistrin e riskut dhe me shkresën nr. 1819, datë 30.04.2012, të Inspektorit të Përgjithshëm e ka miratuar atë por, njësia nuk ka caktuar koordinatorin e rikut.

c. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synin arritjen e objektivave.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave administron deklarin e pasurisë, të detyrimeve financiare dhe realizon kontrollin e këtij deklarimi. Proceset kryesore të punës operationale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë. Kryerja e pagesave apo, urdhër shpenzimi autorizohet pas firmës së nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues. Njësia ka marrë masa paraprake për të pakësuar nivelin e riskut për punonjësit që janë përfshirë në detyra me natyrë delikate pasi, për vitin 2012, njësia ka organizuar trajnime me 20 punonjës me temë "Mbrotja e të dhënave personale", kryesisht për punonjësit në pozicionin Inspektor i Lartë, N/Inspektor i Lartë dhe për punonjësit e Arkiv Protokollit.

Në varësi të Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse është dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit, që ka si qëllim të mirëmbajtje dhe të kontrollojë sistemin e IT.

Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit kompjuterik "Alpha".

d. Informim komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave.

Menaxherët e njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, janë njohur me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe po punohet që të gjithë punonjësit të njohim më në detaje menaxhimin financiar dhe kontrollin. Kujdes i veçantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe të menaxherëve.

Sekretari i Përgjithshëm informohet rregullisht nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve mbështetëse, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, raporteve të monitorimit çdo 3-muaj dhe ky informacion që merret nga nëpunësi zbatues është i mjaftueshëm për vendimmarrjen e menaxhimit. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për realizimin e objektivave institucionale dhe për të plotësuar nevojat e domosdoshme të punonjësve, sistemi i IT-së, afron informacion të nevojshëm. Për arritjen e këtyre objektivave dhe për ruajtjen e të dhënave, njësia disponon një sistem kritik nëpërmjet të cilit administrohen dhe kontrollohen deklaratat e interesave private të zyrtarëve si regjistrim, skanim, kontroll aritmetik e logjik, etj. Për këtë sistem ka një procedure që aplikohet në mbarim të çdo dite pune (back-up i të dhënave dhe ruajtja e tij jashtë serverit). Të drejtat e aksesit në sistem janë në përputhje me hierarkinë dhe funksionin e çdo punonjësi. Aksesi lejohet vetëm për persona të autorizuar.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Njësia auditohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.



e. Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Titullari informohet vazhdimisht nga drejtorët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve apo, raporteve të ndryshme mujore, tremujore dhe vjetore. Drejtuesit nën mbikëqyrjen Inspektorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësit autorizues, monitorojnë realizimin e çdo objekti në përgjegjësinë e gjithsecilit dhe analizojnë shkaqet e mosrealizimeve.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nuk ka strukturë të Auditimit të Brendshëm pasi, është institucion pa struktura vartëse.

2. Auditimi i llogarive të institucionit për vitin 2010, 2011 dhe 2012.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, mbajtja e kontabilitetit për periudhën objekt auditimi, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006, i ndryshuar.

Nga auditimi i bilancit kontabël u konstatua se:

Veprimet kontabël janë kryer në përputhje me dispozitave ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumenteve justifikuese, dhe se janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Sistemi i kontabilitetit mbahet me anë të programit kompjuterik “Alpha” dhe të gjithë veprimet regjistrohen në ditarët përkatës. Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, për vitin 2010, 2011 dhe 2012, Aktivi është i barabartë me Pasivin dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Bilanci Kontabël me tregues të reduktuar për grupet e llogarive të aktivitet paraqitet si më poshtë:

AKTIVI në lekë

Grupet	Emërtimi	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
A	Aktive të Qëndrueshme	113,408,474.40	114,329,662.40	113,593,027.40
B	Aktive Qarkulluese	13,963,957.55	13,893,588.00	16,482,091.86
C	Llogari të tjera aktive	==	==	==
	Totali	127,372,431.95	128,223,250.40	130,075,119.26

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2012 në *Aktivin e Bilancit Kontabël* rezulton se, më datë 31.12.2011 “*Aktivet e Qëndrueshme*” zënë 87.3 % të vlerës totale të aktivitet, ndërsa “*Aktivet Qarkulluese*” zënë 12.7 %.

Aktivet e Qëndrueshme sipas zërave të llogarive përbëhen nga:

A	Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
212.	Ndërtime e Konstruksione	86,649,313.00	87,120,407.00	87,120,407.00
214.	Instal. tek. makine, pajisje, vegla pune	8,130,930.60	10,665,130.60	11,859,019.70
215.	Mjete transporti	11,455,320.00	11,455,320.00	11,455,320.00
218.	Inventar Ekonomik	32,623,886.70	34,242,500.70	35,901,789.60
219.	Amortizimi	-25,583,477.90	-29,153,695.90	-32,743,508.90
24.	Aktive të Qënd. të Trup. të dëmtuara	132,502.00	==	==
	Totali	113,408,474.40	114,329,662.40	113,593,027.40



Për vitin 2012, Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara rezultojnë në vlerën 113,593,027.40 lekë dhe përbëhen nga:

- Llog. 212 "Ndërtime e rikonstruksione", në vlerën 87,120,407 lekë dhe në krahasim me vitin 2010, është shtuar përkatësisht 471,094 lekë ndërsa, në krahasim me vitin 2011, ka mbetur e pa ndryshuar.

- Llog. 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 11,859,019.70 lekë dhe në krahasim me vitin 2010 dhe 2011, është shtuar përkatësisht në vlerën 3,728,089.10 lekë dhe 1,193,889.10 lekë, që ka ardhur kryesisht si rezultat i blerjes së pajisjeve të interceptimit dhe i transferimeve për pajisje të ndryshme nga jashtë sistemit.

- Llog. 215 "Mjete transporti", në vlerën 11,455,320 lekë dhe në krahasim me vitin 2010 dhe 2011, nuk ka ndryshime.

- Llog. 218 "Inventar ekonomik", në vlerën 35,901,789.60 lekë dhe në krahasim me vitin 2010, është shtuar në vlerën 3,277,902.90 lekë ndërsa, në krahasim me vitin 2011, është shtuar në vlerën 1,659,288.90 lekë.

Ndërsa llog. 219 "Amortizimi i AKQT", në fund të vitit 2012, rezulton në vlerën 32,743,508.90 lekë dhe në krahasim me vitin 2010 dhe 2011, është shtuar përkatësisht në vlerën 7,160,031 lekë dhe 3,589,813 lekë, si rezultat i llogaritjes së amortizimeve për mjetet kryesore.

Aktivitet Qarkulluese në fund të vitit 2012, rezultojnë me gjendje në vlerën 16,482,091 lekë dhe sipas zërave paraqiten si më poshtë:

B	Aktivitet Qarkulluese	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
Kl.3	Gjendje inventari	8,711,329.00	9,047,236.00	11,919,412.86
	Nga të cilët:			
31.	Materiale	4,000,445.00	4,072,950.00	7,006,544.36
32.	Objekte inventari	4,710,884.00	4,974,286.00	4,912,868.50
Kl.4	Kërkesa arkëtimi mbi debitorët	5,252,628.55	4,846,352.00	4,562,679.00
	Nga e cila:			
4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	5,203,479.00	4,846,352.00	4,562,679.00
468	Debitorë të ndryshëm	49,149.55	==	==
	Totali	13,963,957.55	13,893,588.00	16,482,091.86

Klasa 3 "Gjendja e inventarit", në fund të vitit 2012, rezulton në vlerën 11,919,412 lekë dhe ndaj totalit të Aktiveve Qarkulluese zë 72.3%. Në krahasim me vitin 2010, është shtuar në vlerën 3,208,083 lekë, ndërsa në krahasim me vitin 2011, është shtuar në vlerën 2,872,176.86 lekë.

Klasa 4 "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët", ndaj totalit të Aktiveve Qarkulluese zë 27.7% dhe përbëhet nga gjendja e llog. 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)", në shumën 4,562,679 lekë.

Llog. 468 "Debitorë të ndryshëm", për vitin 2012 dhe 2011, rezulton pa gjendje ndërsa, për vitin 2010, ka rezultuar me gjendje në shumën 49,149.55 lekë, e cila është likuiduar gjatë vitit 2011.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në fund të vitit 2012, nuk ka gjendje në llog. 512 "Llogari në bankë".

Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit (+/-)", në Formatin nr. 3/1 "Shpenzime të ushtrimit 2012", rezulton me vlerën 2,872,176.86 dhe është sa diferenca e ndryshimit të gjendjes së inventarit të vitit 2012 me vitin 2011, në Klasën 3 të Grupit B "Aktivitet Qarkulluese", në aktiv të bilancit.

Nga auditimi i gjendjes debitore të llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konformë rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogarinë sintetike dhe ato analitike.

Bilanci Kontabël me tregues të reduktuar për grupet e llogarive të pasivit paraqitet si më poshtë:



PASIVI në lekë

Grupet	Emërtimi	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
A	Fonde të veta	122,119,803.40	123,376,898.40	125,512,440.26
B	Detyrime	5,252,628.55	4,846,352	4,562,679
C	Llogari të tjera	==	==	==
	Totali	127,372,431.95	128,223,250.40	130,075,119.26

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Bilancit Kontabël, rezultojnë se "Fondet e veta", më 31.12.2012, zënë rreth 96.5% dhe përbëjnë pjesën kryesore të pasivit të bilancit ndërsa, zëri "Detyrimet", zënë 3.5% ndaj totalit të pasivit.

Në mënyrë të detajuar paraqiten:

Nr.	Emërtimi i llogarive të pasivit	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
A.	Fonde të veta	122,119,803.40	123,376,898.40	125,512,440.26
B.	Detyrime	5,252,628.55	4,846,352.00	4,562,679.00
K1.4	Detyrime afatshkurtër	5,252,628.55	4,846,352.00	4,562,679.00
42	Personeli e llogari të lidhura me to	3,687,923.00	3,329,877.00	3,151,879.00
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	506,753.00	476,659.00	404,182.00
4341	Të tjera operacion me shtetin (kreditor)	49,149.55	==	==
435	Sigurime shoqërore	954,617.00	983,731.00	952,015.00
436	Sigurime shëndetësore	54,186.00	56,085.00	54,603.00
	Totali	127,372,431.95	128,223,250.40	130,075,119.26

Në krahasim me vitin 2010 dhe 2011, në vitin 2012 "Fondet e veta", janë shtuar përkatësisht në vlerën 3,392,636.80 lekë dhe 2,135,541.86 lekë ndërsa, "Detyrimet", në krahasim me vitin 2010, janë pakësuar në shumën 689,949.55 lekë dhe në krahasim me vitin 2011, janë pakësuar në shumën 283,673 lekë, të cilat janë detyrime afatshkurtër për personeli e llogari të lidhura me to, detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa dhe sigurime shoqërore e shëndetësore.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive kreditore rezultojnë se:

1. Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2012, rezultojnë pa gjendje.
2. Llogaria "Personeli e llogari të lidhura me to", rezultojnë me gjendje në shumën 3,151,879 lekë, që përfaqëson pagat për tu paguar.
3. Llogaria "Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa", rezultojnë me gjendje në shumën 404,182 lekë, që përfaqëson detyrimin ndaj shtetit për tatimin mbi të ardhurat.
4. Llogaria "Sigurime Shoqërore", rezultojnë me gjendje në shumën 952,015 lekë.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konformë rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogarinë sintetike dhe ato analitike.

3. Auditimi i zonave të llogarisë.

3.1 Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe Sigurime Shoq. (llog. 601).

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, institucioni ka respektuar strukturën dhe numrin e punonjësve sipas organikës të miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 228, datë 29.01.2009 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive", i ndryshuar me Vendimin nr. 93, datë 07.04.2011. Në bazë të vendimit të mësipërm numri i punonjësve është gjithsej 44.



Nga auditimi konstatua se, të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës së institucionit dhe se, është respektuar struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve për punonjësit e institucionit, duke përfshirë pagën bazë mujore dhe shtesat mbi pagë.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë, për periudhën objekt auditimi, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Emërtimi	3-mujori IV-të 2010			Viti 2011			Viti 2012		
	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
Pagat (600)	14,300	13,185	92.2	55,068	54,456	98.9	52,978	52,563	99.2
Sig. Shoq. (601)	1,700	1,605	94.4	7,000	6,484	92.6	6,782	6,716	99
Fondi i veçantë	440	430	97.7	2,723	1,890	69.4	600	600	100
Nga i cili:									
-Shpërb. për punë të mirë	-	-	-	-	1,450	-	-	-	-
-Shpërb. në fund të vitit	-	430	-	-	440	-	-	440	-
-Për sëmundje	-	-	-	-	-	-	-	50	-
-Për aktivitet social-kult.	-	-	-	-	-	-	-	110	-

Nga sa më lart rezulton se, për 3-mujorin e IV-të të vitit 2010, fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është realizuar përkatësisht në masën 92.2% dhe 94.4%, për vitin 2011, është realizuar në masën 98.9% dhe 92.6% dhe për vitin 2012, është realizuar në masën 99.2% dhe 99%.

Fondi i veçantë për 3-mujorin e IV-të të vitit 2010, është realizuar në masën 97.7%, për vitin 2011, është realizuar në masën 69.4% dhe për vitin 2012, është realizuar në masën 100%. Për 3-mujorin e IV-të të vitit 2010, nga fondi i veçantë janë përdorur gjithsej 430 mijë lekë për shpërblime në fund të vitit, për vitin 2011, janë përdorur gjithsej 1,890 mijë lekë, nga të cilët për shpërblime për punë të mirë 1,450 mijë lekë dhe për shpërblime në fund të vitit 440 mijë lekë. Për vitin 2012, janë përdorur gjithsej 600 mijë lekë, nga të cilët 440 mijë lekë për shpërblime për punë të mirë, 50 mijë lekë për sëmundje dhe 110 mijë lekë për aktivitete social kulturore.

Nga auditimi me zgjedhje, për pagat, sigurimet shoqërore, fondin e veçantë, tatimin mbi të ardhurat personale, etj., rezultoi se, ato janë llogaritur drejt në bazë të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

3.2 Mallra dhe shërbime (llog. 602).

- Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Nga auditimi i kryer për veprimet e arkës në lekë dhe valutë dhe ato nëpërmjet bankës rezultoi se, veprimet kontabël janë kryer në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre", i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera me zgjedhje nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, për periudhën objekt auditimi rezultoi se, regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim sipas datës së vlerësimit kontabël, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës. Të gjitha mandatarkëtimet dhe mandatpagesat janë plotësuar dhe firmosur në rregull, sipas të dhënave të dokumentave justifikuese. Për çdo muaj është kuadruar ditari i arkës me gjëndjen e librit të arkës.

Nga verifikimi i pagesave të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë rezultoi se, shpenzimet janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

b. Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të bankës për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, dhe vitet 2011 e 2012 rezultoi se, veprimet kontabël janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.



Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës është bërë në llogarinë 580 "Xhirimi i vlerave monetare", llogari e cila në fund të periudhës paraqitet e mbyllur.

Pagesat e kryera me urdhër xhirimi, janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në ditar dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me ekstraktin e saj.

Nga auditimi me zgjedhje i pagesave për shërbimet e udhëtimit e dietave brenda vendit në zbatim të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", si dhe Urdhrit të Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit me shkresën nr. 125, datë 26.12.2011 "Për miratimin e hartave të azhurnuara të rrjetit rrugor kombëtar dhe të distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë", nuk u konstatuan shkelje. Llogaritja e dietave është bërë sipas dokumenteve të firmosura, nga titullari i institucionit, në të cilat është përcaktuar qëllimi i shërbimit dhe afati i kryerjes së tij.

Shpenzimet për udhëtim dieta brenda vendit, për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, janë në shumën 92 mijë lekë dhe zënë 0.4% të totalit të shpenzimeve administrative, për vitin 2011, janë në shumën 99 mijë lekë dhe zënë 0.5% të shpenzimeve administrative dhe për vitin 2012, janë në shumën 100 mijë lekë dhe zënë 0.5% të shpenzimeve administrative. Për periudhën objekt auditimi janë shpenzuar gjithsej për udhëtim e dieta 291 mijë lekë.

U auditua zbatimi i VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Shpenzime pritje e përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1999 dhe rezultoi se, të gjithë shpenzimet për pritje e përcjellje për 3-mujorin e fundit të vitit 2010, vitet 2011 dhe 2012, kishin programe për pritje e përcjellje, listën emrore të delegacioneve të huaja që merrnin pjesë në drekë apo darkë, ku përcaktohesh pjesmarrja të huaj dhe vendas, çka tregon që programet ishin hartuar në zbatim të vendimeve në fuqi.

Për periudhën objekt auditimi, rezultoi të jenë blerë me procedurën "Blerje me vlerë të vogël", 21 artikuj, gjithsej në vlerën 18,243 mijë lekë (1,256+8,358+8,629) dhe në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve operative të llog. (602), zënë rreth 22%, për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, rreth 40%, për vitin 2011 dhe 44%, për vitin 2012.

Peshën specifike më të madhe në totalin e shpenzimeve operative për periudhën objekt auditimi e ka zëri "Shpenzime të telefonisë fikse". Për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, janë shpenzuar 382 mijë lekë ose, 6.9% të shpenzimeve operative, për vitin 2011, janë shpenzuar 1,394 mijë lekë ose, 6.8% dhe për vitin 2012, janë shpenzuar 2,010 mijë lekë ose, 10.3% të totalit të shpenzimeve operative.

Blerjet për mallra dhe shërbimet me vlerë të vogël të likuiduara me pagesat e bankës, janë kryer sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VI, pika 2 "Për blerjet me vlerë të vogël". Të gjithë pagesat janë kryer mbi bazën e urdhër prokurimeve, ku kanë të përcaktuar natyrën dhe sasinë e mallrave, procesverbaleve të mbajtur për caktimin e çmimit më të ulët pas kontakteve me operatorët ekonomik, faturave të shitësit dhe fletëhyrjeve të magazinës.

c. Gjendja e mallrave stok dhe qarkullim të ngadalshëm.

Nga auditimi dokumentacionit të kryera në magazinë për periudhën objekt auditimi rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe materialeve të magazinës është plotësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha hyrjet në magazinë janë shoqëruar me dokumente justifikuese sipas neni 6, pika 1, germa "dh" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar të Kontrollit" dhe sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financës nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Të gjithë daljet nga magazina janë kryer me urdhër dorëzimi. Pajisjet dhe mallrat e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale. Nga auditimi në magazinë nuk rezultuan mallra stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.



d. Analiza e shpenzimeve për mjetet e transportit.

Për periudhën objekt auditimi institucioni, ka në inventar dhe në gjendje pune 3 automjete, me vlerë 11,455,320 lekë. Numri i automjeteve është në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoqërive në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”.

Inspektori i Përgjithshëm, për disiplinimin e shpenzimeve të transportit ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm me numër protokollit 1 979 dhe numër 73, datë 04.12.2008 “Për nxjerrjen e normativës së konsumit të karburanteve të automjeteve” por, megjithese ka ndryshuar gjendja teknike e automjeteve, nuk janë bërë përmirësimet e duhura për normativat e shpenzimeve të karburantit.

Specialisti i Sektorit Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse, në bazë të fletë udhëtimeve ka mbajtur procesverbale për çdo muaj dhe ka llogaritur normativën e konsumimit të karburantit për 100 km, për 3 autoveturat.

Për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, janë konsumuar 400 litra naftë, në vlerën 48,167 lekë, për vitin 2011, janë konsumuar 9,312 litra naftë, në vlerën 1,356,289 lekë dhe për vitin 2012, janë konsumuar 7,480 litra naftë, në vlerën 1,366,368 lekë.

Riparimet për 3 automjetet janë kryer mbi bazën e procedurave të prokurimit. Për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, vitet 2011 dhe 2012, automjetet Tip “Mercedes Benz”, “Wolkswagen” dhe “Hyundai”, janë riparuar tek Servis “Auto 2000” shpk. Për riparimin e tyre për periudhën objekt auditimi janë shpenzuar gjithsej 2,902,651 mijë lekë, nga të cilët për 3/mujorin e fundit të vitit 2010, janë shpenzuar 642,451 lekë, për vitin 2011, janë shpenzuar 1,181,520 lekë dhe për vitin 2012, janë shpenzuar 1,078,680 mijë lekë.

Nga krahasimi i shpenzimeve për riparimin e automjeteve rezulton se, në vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, janë shpenzuar më pak në vlerën 102,840 lekë, çka tregon për një ulje të shpenzimeve nga vit në vit.

e. Mbi inventarizimin e pasurisë së institucionit.

Për periudhën objekt auditimi, inventari fizik i vlerave materiale dhe inventari i imët është kryer sipas urdhrave të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 46, datë 14.10.2010, nr. 513, datë 07.10.2011 dhe nr. 414, datë 09.10.2012 “Mbi inventarizimin e aktiveve inventar i imët dhe aktiveve të qëndrueshme në përdorim të punonjësve të ILDKP-së”, bazuar në nenin 6, pika 1, germa “e” e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kapitulli IV “Inventarizimi i aktiveve”, pikat 42, 43. Për këtë qëllim është ngritur komisioni për inventarizimin e mjeteve kryesore në përdorim, i mjeteve të transportit, inventarit ekonomik, inventarit të imët dhe inventarit të materialeve në magazinë. Për materialet jashtë përdorimit, për pajisjet që janë të dëmtuara të ndodhura stok në magazinë me Urdhrat e Brendshëm të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP-së, nr. 46/1, datë 14.10.2010, nr. 3747, datë 17.11.2011 dhe nr. 444, datë 15.11.2012 “Për miratimin e komisionit të vlerësimit dhe të asgjësimit të vlerave materiale që nxirren jashtë përdorimit”, është ngritur komisioni për materialet jashtë përdorimit sipas vendimeve në fuqi. Të gjitha fletët e inventarit janë plotësuar në sasi dhe në vlerë dhe janë të firmosura nga të gjithë antarët e komisionit. Fletët e inventarit dhe kartelat personale të çdo punonjësi ishin të rakorduar me përmbledhësen e inventarit.

Gjithashtu, për plotësimin e nevoja të tij për periudhën objekt auditimi, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka zhvilluar procedura prokurimi për mallra dhe shërbime, për të cilat u audituan procedurat e prokurimit si më poshtë:

Për periudhën tetor-dhjetor 2010, institucioni nuk ka zhvilluar asnjë procedurë prokurimi.

Bazuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, pika 3, germa b, për periudhën objekt auditimi, institucioni ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, regjistrin e parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike.



